



# AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI

3M II - 2024

*(Prill-Qershor)*

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit.....	3
1.1. Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare .....	3
1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare.....	3
1.3. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI) .....	5
2.Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie.....	6
3.Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim .....	7
4. Përfaqësimi Ligjor .....	7
5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera .....	8
5.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015 .....	8
5.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) .....	9
5.2.1. Raportime periodike mujore pranë ZOS për aplikimet.....	9
5.2.2. Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.....	10
6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave .....	11
6.1. Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së.....	11
6.2. Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 .....	11
6.3. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i bashkëqeverisjes .....	12
6.4. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës .....	12
6.5. Shërbime elektronike të ofruara nga ATP.....	13
7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit .....	14
7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2024 duke u bazuar në 6M – I 2024, i pa kuadruar nga thesari .....	14
7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, per 6M – I 2024, i pa kuadruar nga thesari .....	14
7.3. Informacioni shpenzime për Aluiznin dhe Kompensim Financiar, dhe me raste të veçanta 15	

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ushtron aktivitetin në zbatim të Ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore VKM nr. 221/2016, VKM nr. 222/2016, i ndryshuar dhe VKM nr. 223/2016, ndryshuar.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.221, datë 23.3.2016, “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave“, paraqet raportin 3 mujor të punës për periudhën Prill-Qershor 2024.

## **1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit**

### **1.1. Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare**

Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në mbylljen e procesit të vlerësimit, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar procedurat ligjore të vlerësimit financiar për **26 092 vendime** përfundimtare me të drejtë kompensimi, të viteve 1993 – 2013, si vijon:

- ▶ **19 987 vendime** u vlerësuan financiarisht;
- ▶ Vlera për këto vendime është **116,149,629,679 lekë** (një qind e gjashtëmbëdhjetë miliard e një qind e dyzet e nëntë milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtë qind e shtatë dhjetë e nëntë). Vlera pritet të ndryshojë, pasi ATP është në pritje të përfundimit të ankimimeve nga subjektet në bazë të afateve ligjore;
- ▶ **2817 vendime** ku nuk është përcaktuar se ku bie parablerja;
- ▶ **2460 vendime** të cilat subjekti konsiderohet i kompensuar vlera nga - **27,287,716,865.14 lekë** (minus njëzetë e shtatë miliard e dy qind e tetëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) shkon në **-19,716,407,223 lekë** (minus nëntëmbëdhjetë miliard e shtatë qind e gjashtëmbëdhjetë milion e katër qind e shtatë mijë e dy qind e njëzetë e tre);
- ▶ **748 vendimet** të fshira gjatë procesit të rivlerësimit të vendimeve;
- ▶ **80 vendime** të fshira sipas memove të miratuara dhe e-mail të dërguara nga grupet e punës.

### **1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare**

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka konstatuar **3758 vendime** me të drejtë kompensimi që përfitojnë në bazë të ligjit 77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, fatura financiare e të cilave arrin në **15,015,520,688.88 lekë** (pesëmbëdhjetë miliard e pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet mijë e gjashtë qind e tetëdhjetë e tetë pike tetëdhjetë e tetë), nga të cilat:

- ▶ **1025 vendime** të njohura për kompensim me vlerë pozitive. Vlera e publikuar për këto vendime para ndryshimeve ligjore ishte **2,209,000,380.13 lekë** (dy miliard e dyqind nëntë milion e treqind e tetëdhjetë mijë pikë trembëdhjetë) dhe shkon në **6,897,168,379.95 lekë** (gjashtë miliard e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tre qind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e pesë).
- ▶ **1253 vendime** të njohura për kompensim të cilat sipas ligjit nr. 133/2015 konsideroheshin të ezauruara dhe që sipas formulës së re të ligjit, marrin vlerë pozitive. Vlera e publikuar për këto vendime para ndryshimeve ligjore ishte - **49,497,717,941.49 lekë** (minus dyzet e nëntë miliard e katër qind e nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind

e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntë qind e dyzet e një pikë dyzet e nëntë) dhe shkon në **10,327,352,689.06 lekë** (dhjetë miliard e tre qind e njëzet e shtatë milion e tre qind e pesë dhjetë e dy mijë e gjashtë qind e tetë dhjetë e nëntë pikë gjashtë).

- ▶ **1480 vendime**, për të cilat subjekti konsiderohet i kompensuar (me vlerë negative) dhe rezulton po i tillë edhe sipas formulës së re (thjesht zvogëlohet vlera negative). Vlera e publikuar për këto vendime para ndryshimeve ligjore ishte – **104,234,304,718.19 lekë** (minus një qind e katër miliard e dy qind e tridhjetë e katër milion e tre qind e katër mijë e shtatë qind e tetëmbëdhjetë pikë nëntëmbëdhjetë) dhe shkon në – **7,133,468,610.45 lekë** (minus shtatë miliard e një qind e tridhjetë e tre milion e katër qind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtë qind e dhjetë pikë dyzet e pesë).

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.5, datë 13.02.2024, vendosi rrëzimin e kërkesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022. Gjykata vlerësoi se skema e re e përdorur nga ligji nr. 77/2022 dhe aktet ligjore të dala në zbatim të tij, konsiderohen të pranueshme referuar parimeve të aplikuara nga nenet 17 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. ATP ka vijuar me njoftimin e të gjitha subjekteve të interesuar se do të vijojë rregullisht procedurat për trajtimin e aplikimeve për ekzekutimin e vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit, si dhe shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie brenda afateve ligjore.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer përditësimin dhe publikimin e rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së [www.atp.gov.al](http://www.atp.gov.al).

Gjatë periudhës **Prill – Qershor 2024**, për Kompensimin Financiar dhe Fizik dhe Kompensim me Kërkesë të Veçantë rezulton se:

- ▶ Janë regjistruar **110 aplikime** nga subjektet nga të cilat **100** për Kompensim Fizik Financiar dhe **10** për Kompensim me Kërkesë të Veçantë;
- ▶ Janë hapur **15** dosje të reja për Kompensim Financiar dhe Fizik dhe **4** për Kompensim me Kërkesë të Veçantë.

Sqarojmë se mosveprimi i ATP-së lidhur me aplikimet e konfirmuara ka ardhur si rezultat i mbetjes vakant të pozicionit drejtues të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së nga data 05.04.2024 deri me datë 20.06.2024. Bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 133/2015, të ndryshuar, si dhe në pikën 10 të VKM-së nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronës”, atributi vendimmarrës në ATP është një kompetencë eksklusive, të cilën ligji ia ngarkon vetëm Drejtorit të Përgjithshëm të këtij institucioni.

Gjatë periudhës **Janar – Qershor 2024**, për Kompensimin Financiar dhe Fizik dhe Kompensim me Kërkesë Veçantë, rezulton se:

- ▶ Janë regjistruar **210 aplikime** nga subjektet nga të cilat **188** për Kompensim Fizik Financiar dhe **22** për Kompensim me Kërkesë të Veçantë;
- ▶ Janë ekzekutuar **77** dosje nga të cilat:
  - 74 dosje** për Kompensim me kërkesë të Veçantë për këste të kaluara dhe vlera e shpërndarë është **219,410,760.86 lekë** (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e dhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë), dhe **3 dosje** të

trajtuara me **40%**. Kësti i parë që ka kaluar për këto dosje është **14,227,173.52 lekë** (katërbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e njëqinde shtatëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e dy);

-Totali që do të përfitojnë subjektet për **5 vitet** e ardhshme nga kjo formë kompensimi është **71,135,867.60 lekë** (shtatëdhjetë e një milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë);

-Vlera që kursen shteti është **106,703,801.40 lekë** (njëqind e gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e tre mijë e tetëqind e një pikë dyzet);

-**2 dosje** për Kompensim Fizik/Financiar deri në **1.5 milionë lekë** me vlerën **1,412,138.26 lekë** (një milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë mijë pikë njëzet e gjashtë)

Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në **Qershor 2024**, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ekzekutuar **818 vendime** me një vlerë prej **7,964,046,315.83 lekë** (shtatë miliard e nëntë qinde gjashtëdhjetë e katër milion e dyzetë e gjashtë mijë e tre qind e pesëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) (vlera e Kompensimit Financiar plus vlera e llogaritur për Kompensim Financiar me Kërkesa të Veçanta), nga të cilat **82** vendime janë mbyllje procedimi. Gjithashtu është shpërndarë **717.8 ha** tokë nga fondi fizik.

### 1.3. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

ATP trajton kërkesat e subjekteve në zbatim të VKM-së nr. 383 datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar. Që prej fillimit të procesit janë miratuar **80 VKM** (VKM per te cilat janë hapur aplikimet) në bazë të së cilave miratohen listat e subjekteve përfituese dhe pasurive përkatëse. Pranë ATP-së janë administruar kërkesat e **13 110 subjekteve** për përfitim të kompensimit, nga të cilat **58 501** janë subjekte përfituese. Janë ekzekutuar **9 065** aplikime në masën **70%**. Sipërfaqja e trajtuar nga këto VKM është **3 433 910.18 m<sup>2</sup>**.

Për periudhën **Prill-Qershor** kanë aplikuar **241 subjekte**.

Për periudhën **Janar-Qershor 2024** kanë aplikuar online **600 subjekte** për kompensim për pronat e zëna nga ndërtimet informale, ndër të cilat nuk konstatohet asnjë aplikim nga Komunitetet Fetare. ATP-ja ka përpunuar dokumentacionin origjinal të dërguar nga subjektet nëpërmjet shërbimit postar për të gjitha këto aplikime. Ka filluar shqyrtimin administrativ të kërkesave duke bërë konfirmime me zyrat vendore të ASHK-ve përkatëse.

Janë trajtuar **100 aplikime** dhe është shpërndarë në favor të subjekteve një vlerë prej **109,015,941.23 lekë** (njëqind e nëntë milionë e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e një dhe pika njëzet e tre).

*Evidenca e indikatorëve për ALUIZNI, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Përfitimi i shpërblimit për ndërtimet informale (ALUIZNI)			
Indikatorët	3M - I	3M - II	TOTALI
Nr. i aplikimeve on line nga subjektet	359	241	600
Nr.i aplikimeve të trajtuara	100	0	100
Vlera e shërndarë (në lekë)	109,015,941.23	0	109,015,941.23

## 2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas ligjit 133/2015. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, afati i përcaktuar në nenin 34 pika 1 ka ndryshuar. Neni i cili më parë parashikonte se nëse ATP nuk përmbushte detyrimin për të trajtuar kërkesat në afatin 3-vjeçar, subjektet mund të drejtoheshin gjykatës së shkallës së parë për trajtimin e tyre, tani është ndryshuar duke vendosur një afat trajtimi brenda datës 31.12.2024. Në këto kushte, ATP-ja vazhdon të trajtojë dosjet dhe kërkesat e subjekteve, përfshirë ato të patërhequra, të tërhequra dhe ato që i janë drejtuar gjykatës, në përputhje me dispozitat e nenit 34, pika 2 të ligjit 133/2015, i ndryshuar.

Nga data 24.05.2023 kur u miratuan ndryshimet në vendimin nr. 222, datë 23.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës” e ndryshuar, Drejtoria e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie ka vijuar me shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie.

Aktualisht janë 7055 dosje/praktika të pa trajtuara me vendim nga të cilat 666 janë dosje/praktika të rikthyera për trajtim pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave sipas përcaktimeve në nenin 9, pika 2 i ligjit 77/2022.

Në funksion të procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohje pronësie është filluar procedimi administrativ për 2937 dosje/praktika për të cilat i është dërguar subjekteve kërkesues njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe hartografik, të ndara si më poshtë:

▶ Dosje/Praktika Qarku Durrës	344
▶ Dosje/Praktika Qarku Elbasan	67
▶ Dosje/Praktika Qarku Gjirokastër	383
▶ Dosje/Praktika Qarku Lezhë	88
▶ Dosje/Praktika Qarku Vlorë	660
▶ Dosje/Praktika Qarku Berat	62
▶ Dosje/Praktika Qarku Dibër	12
▶ Dosje/Praktika Qarku Fier	315
▶ Dosje/Praktika Qarku Korçë	235
▶ Dosje/Praktika Qarku Kukës	25
▶ Dosje/Praktika Qarku Shkodër	407
▶ Dosje/Praktika Qarku Tiranë	339

Për periudhën **Janar-Qershor 2024** janë trajtuar me përgjigje zyrtare:

- ▶ **16** kërkesa zyrtare;
- ▶ **134** kërkesa qytetare;
- ▶ **225** dosje/praktika të rikthyera në ATP;
- ▶ **167** Kërkesë/ankesa të ardhura në portalin e-Albania si dhe në atë të bashkëqeverisjes;
- ▶ Janë bërë **307** depozitime dokumentacioni në dosje/praktika;
- ▶ Janë trajtuar me vendim **30** dosje/praktika;
- ▶ Janë trajtuar me memo **12** dosje;
- ▶ Janë kryer **937** njoftime për dosjet/praktikat.

### 3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Për 6-mujorin e parë të vitit 2024, Sektori i Verifikimit të Fondit Fizik në zbatim të nenit 12, të ligjit 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore, ka kryer këtë veprimtari:

Është kryer korespondenca me të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore, të cilat nuk kanë sjellë më parë informacion në lidhje me konfirmimin prej tyre, nëse janë ndarë me ligjin 7501/1991 “Për tokën”, pasuritë e paluajtshme, pjesë e fondit fizik të tokës bujqësore të kaluara me VKM-në nr.770, datë 12.11.2014 “Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368,8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësite të qeverisjes vendore”. Nga totali i kërkesave për konfirmimin e të dhënave për 19 723 numra pasurie tokë bujqësore, janë konfirmuar deri tani të dhënat për 4 039 numra pasurie. Këto të dhëna janë përditësuar në bazën e të dhënave të krijuar për këtë fond.

Në zbatim të VKM-së 1077/2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullor”, në saj të bashkëpunimit me disa institucione shtetërore brenda këtij 6-mujori është bërë e mundur marrja e hartave të disa ekonomive pyjore të vendit dhe bazuar në to ka filluar procesi i hedhjes së tyre në Web-Gis për 84 ekonomi pyjore dhe përpilimi në formatet e kërkuara nga ASHK. Janë përgatitur 29 plan-vendosje të ekonomive pyjore në Qarkun e Tiranës dhe janë dërguar DVASHK përkatëse për konfirmimin prej tyre të të dhënave në lidhje me statuset juridike, (për fillimin prej tyre të procedurave të regjistrimit fillestar për ato pasuri që nuk është kryer ky proces), si edhe vazhdimin e procedurave të nevojshme për bllokimin e tyre në favor të ATP-së.

Gjithashtu në zbatim të VKM-së nr.926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes” dhe pararendëseve të saj të cilat janë shfuqizuar (VKM nr.794, datë 21.11.2007, VKM nr.1638, datë 17.12.2008 dhe VKM nr.428, datë 09.06.2010) për gjithë objektet shtetërore që kanë kaluar në dispozicion të ATP-së, brenda këtij 6-mujori është kryer verifikimi në terren për 80 objekte të kaluara ATP-së në gjashtë Qarqe të vendit dhe janë përgatitur materialet e akt verifikimeve përkatëse si edhe të dhëna të tjera.

Është realizuar korespondenca me institucione të ndryshme apo subjekte privatë, në lidhje me fondin fizik në dispozicion të ATP-së, për ato numra pasurie që janë pjesë e fondit fizik ku ata janë të interesuar për zhvillimin/ndryshimin e tyre.

### 4. Përfaqësimi Ligjor

Një nga veprimtaritë e ATP-së është dhe mbrojtja e interesave të saj në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite. Nga Përfaqësimi Ligjor i ATP-së pranë gjykatave rezulton:

Për periudhën **Janar-Qershor 2024** janë depozituar **148 padi** në të gjitha gjykatat e vendit, në gjykatat e rretheve, në gjykatat e apelit, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në apelin administrativ.

- ▶ **148 çështje** janë mbyllur me vendim;
- ▶ **43 çështje** janë rrëzuar;
- ▶ **63 çështje** kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e çështjes;

- ▶ Janë ushtruar **21 ankime** dhe **13 rekurse**. Në total **34**.

Duke patur në vëmendje ndryshimet ligjore dhe kryesisht të akteve nënligjore që përcaktojnë procedurat dhe rregullat e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e pronës të dhënat e mësipërme mund të konsiderohen si një ecuri pozitive e veprimtarisë së përfaqësimit ligjor pranë gjykatave dhe në veçanti në juridiksionin administrativ.

- ▶ Në lidhje me vendimmarrjen e ATP-së sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të nenit 29 të ligjit 133/2015 nuk janë depozituar padi të reja;  
Pranuar **5 padi**, pushuar **5 padi**, kthim aktesh ose pushuar **2 padi**.
- ▶ Në lidhje me kundërshtimin e vlerësimit financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit parashikuar në nenin 19 të ligjit janë depozituar **3 padi të reja** në ATP;  
Pranuar **3 padi**, rrëzuar **2 padi** dhe pushuar **1 padi**.
- ▶ Në lidhje me vlerësimin financiar të vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit parashikuar në nenin 15 të ligjit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është depozituar **1padi**;  
Pranuar **3 padi**, kthim aktesh ose pushuar **1 padi**.
- ▶ Në lidhje me njohjen e të drejtës së pronësisë në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit janë depozituar **41 padi**.  
Pranuar **12 padi**, rrëzuar **10 padi** dhe pezulluar **25 padi**.

## 5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucione të tjera

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

### 5.1.Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave, siç vijon:

- ▶ Kontributi i parë institucional për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024.
- ▶ Në kuadër të procesit të hartimit të “Instrumentit të planifikimit për periudhën Janar-Dhjetor 2024” sipas metodologjisë së PSIE është kryer përditësim në lidhje me masat institucionale për zbatim nga ATP.
- ▶ Raportim periodik vjetor 2023 pranë Ministrisë së Drejtësisë, Kryeministrisë, Kuvendit dhe Komisioneve Parlamentare sipas përcaktimit në ligjin 133/2015.
- ▶ Është raportuar në lidhje me pyetjet e parashtruara nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut, në raportin për zbatimin e detyrimeve të saj, në kuadër të Mekanizmit të Shqyrtimit Periodik Universal.
- ▶ Punuar dhe raportuar në zyrën e Ministres së Shtetit dhe Kryenegociatores në lidhje me takimin e 15-të të Nënkomitetit BE-Shqipëri, takim i cili u zhvillua në Bruksel në dt.20-21.03.2024.
- ▶ Kontributi mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, raportimi periodik vjetor për vitin 2023.

- ▶ Punuar dhe raportuar mbi Mekanizmin e Udhërrëfyesit mbi Shtetin e së Drejtës.
- ▶ Raportim periodik mujor pranë ZOS (Zyra Operacionale Situatës) në Kryeministri në lidhje me indikatorët “Shërbime ndaj qytetarëve” dhe “Skanime/Hartografime”
- ▶ Përditësim mbi procedurat dhe kontributin e ATP-së në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.
- ▶ Përditësim të informacioneve lidhur me të dhënat të pronës, si një nga prioritetet e qeverisë.
- ▶ Përgatitur material për Ministrinë e Drejtësisë për periudhën 2018-2024.
- ▶ Përgatitur fjala për Ministrin në lidhje me realizimin e masave kompensim / kthim prone dhe përfaqësim ligjor.
- ▶ Punuar raporti për PSIE për periudhën prill-qershor 2024.
- ▶ Hartim dhe publikim i Ditarit Mujor në faqen e Web-it të Institucionit.
- ▶ Hartim dhe raportim javor pranë Drejtorit të Përgjithshëm për realizimin dhe planifikimin javor të detyrave institucionale, sektoriale dhe individuale.

## 5.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)

### 5.2.1. Raportime periodike mujore pranë ZOS për aplikimet

Nga evidencat e raportimeve periodike mujore pranë ZOS, **Janar-Qershor 2024** rezulton:

- ▶ Aplikime të plota: **3121**
- ▶ Total i shërbimeve të lëvruara: **682**
- ▶ Plotesim dokumentacioni: **412**
- ▶ Aplikime për Kompensim ALUIZNI: **600**
- ▶ Aplikime për Kompensim Financiar/Fizik dhe Kërkesë të Veçantë: **22**
- ▶ Aplikime pa vendimarrje: **2311**

*Evidenca e indikatorëve për ZOS, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Nr.	Indikatori	3M - I	3M - II	TOTALI
1	Aplikime të plota	1701	1420	<b>3121</b>
2	Aplikime të paplota	N/A	N/A	<b>N/A</b>
3	Aplikime të mbartura	593	624	<b>1217</b>
4	Total i shërbimeve të lëvruara	362	320	<b>682</b>
5	Shërbime të lëvruara brenda afatit	340	295	<b>635</b>
6	Shërbime të lëvruara jashtë afatit	22	25	<b>47</b>
7	Plotësim dokumentacioni	287	125	<b>412</b>
8	Ankesa të reja	0	0	<b>0</b>
9	Ankesa të mbartura	24	24	<b>24</b>
10	Numri total i ankesave të zgjidhura/shqyrtuara	0	0	<b>0</b>
11	Nr. ankesash të zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	0	0	<b>0</b>
12	Nr. ankesash të zgjidhura/shqyrtuara jashtë afatit	0	0	<b>0</b>
13	Aplikime për Kompensim nga ALUIZNI	359	241	<b>600</b>
14	Aplikime për Kompensim me Kërkesa të Vecanta	12	10	<b>22</b>
15	Aplikime për Kompensimim Financiar dhe Fizik	88	100	<b>188</b>

16	Aplikime për shërbime pa vendimmarrje	1242	1069	<b>2311</b>
----	---------------------------------------	------	------	-------------

### 5.2.2. Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis

Nga evidencat e raportimeve mujore pranë ZOS, për periudhën **Janar-Qershor 2024**, rezulton:

*Evidenca e indikatorëve për skanime/hartografime, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Indikator	Periudha e raportimit 6M-I 2024		
	3M - I	3M - II	TOTALI
Skanime	24	20	44
Hartografime	6	1	7

*Shënim: Hartografimet kryhen në moment që ka kërkesa nga subjektet për saktësim harte të vendimit përkatës.*

### 5.2.3 Raportime periodike nga Sektori i Asistencës Ligjore

Janë trajtuar 341 kërkesa zyrtare nga AIDA, ASHK, DPP, Kryeministria, MF, GJ.SH.PARË, bashki të ndryshme etj. të cilët kërkojnë informacione të ndryshme. Janë kërkesa zyrtare që kërkojnë informacione të ndryshme me konkretisht si më poshtë:

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve - 21 (njëzet e një) shkresa, ku është dhënë informacion mbi zona të ndryshme ku janë propozuar investime nga sipërmarrje në sektorin e turizmit, energjisë, ekonomisë nëse ka vendime me objekt njohjen, kthimin apo kompensimin e pronave.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës - 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) shkresa, ku është dhënë informacion nëse mbi pasuri të caktuara ka vendime me objekt njohjen, kthimin apo kompensimin e pronave. Ky proces kryhet për arsye sepse subjekte të ndryshme kanë aplikuar pranë ASHK-së për procedurën e kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 apo regjistrim të AMTP-ve.

Bashki - 5 (pesë) shkresa, ku është dhënë informacion kryesisht nëse ngastra pyjore, të ndodhura në ekonominë pyjore janë trajtuar me vendime për njohje, kthim apo kompensim prone.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Dega e Shoqërive Publike - 5 (pesë) shkresa, ku është kërkuar konfirmim nëse mbi prona të ndryshme të cilat janë në proces privatizimi ka vendime për njohje kthim apo kompensim prone dhe konfirmim për çmim të sipërfaqes së pronës shtetërore bazuar në VKM 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik - 3 (tre) shkresa, në lidhje me pasuri të ndryshme në dobi të trupit diplomatik, është dhënë informacion nëse ka vendime për njohje, kthim/kompensim prone.

Gjykatat e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm - 13 (trembëdhjetë) shkresa, ku është dhënë informacion nëse mbi

pasuri të ndryshme objekt gjykimi ka të miratuara vendime për njohje kthim apo kompensim pronë si dhe nëse ka të administruara pranë ATP-së, kërkesa të patrajuara me vendim.

Ministria e Drejtësisë - 3 (tre) shkresa, në lidhje me pasuri të ndryshme nëse është dhënë informacion nëse ka vendime për njohje, kthim/kompensim prone apo të drejtën e parablerjes.

Avokatura e Shtetit - 2 (dy) shkresa, në lidhje me pasuri të ndryshme nëse është dhënë informacion nëse ka vendime për njohje, kthim/kompensim prone apo të drejtën e parablerjes.

Kuvendi - 1 (një) shkresë, në lidhje me pasuri të ndryshme nëse është dhënë informacion nëse ka vendime për njohje, kthim/kompensim prone apo të drejtën e parablerjes.

Kryeministria - 2 (dy) shkresa me anë të së cilave është kërkuar mendim për projektvendime të ndryshme të propozuara nga Këshilli i Ministrave.

171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) janë kërkesa nga Sektori i Përfaqësimit Ligjor, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe analizimin e akteve të ekspertimit duke u referuar në kërkesë-paditë e përcjella nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit apo Avokatët e Shtetit në Nivel vendor etj.

## 6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave

### 6.1. Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së

Për periudhën **Janar - Qershor 2024**, nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese:

*Evidenca e indikatorëve për sektorin e protokollit, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Indikatorët	Treguesit statistikor	Periudha e raportimit 6M-I 2024		
		3M - I	3M - II	TOTALI
Trajtimi i shkresave në ATP	Numri i shkresave hyrëse zyrtare	1593	1793	<b>3386</b>
	Numri i shkresave hyrëse qytetare	1440	970	<b>2410</b>
	Numri i shkresave dalëse me përgjigje zyrtare	1103	1196	<b>2299</b>
	Numri i shkresave dalëse me përgjigje qytetare	1729	1066	<b>2795</b>
	Shkresa të brendshme	765	562	<b>1327</b>

### 6.2. Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin për periudhën **Janar-Mars 2024**, në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, nga ku rezultoi se në ATP nuk ka patur asnjë rast të denoncuar.

Gjithashtu, për periudhën **Prill-Qershor 2024** nga kontrolli dhe verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe i denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave rezultojnë se në Grupin e Punës Anti Korrupsion nuk ka patur asnjë rast

të denoncuar. Jemi në pritje të miratimit të strategjisë së re antikorrupsion 2024-2030, për të vijuar me hartimin dhe miratimin e Planit të Integritetit 2024-2026.

### 6.3. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i bashkëqeverisjes

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesat dhe ankesat të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Për periudhën **Janar-Qershor 2024**, janë trajtuar me përgjigje **91 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- ▶ **27** kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e Kompensimit Financiar/Fizik;
- ▶ **49** kërkesë/ankesa për procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve, tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale;
- ▶ **8** kërkesë/ankesa për Sektorin e Arkivës/Protokollit/Marrëdhënieve me Publikun;
- ▶ **7** kërkesë/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor.

### 6.4. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës

Në Arkivën e ATP-së për periudhën **Janar-Qershor 2024** rezulton se janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **847 dosje dhe praktika** të cilat kanë zbritur në arkiv nga sektorët dhe janë hedhur në sistemin Web-GIS, të detajuara si vijon:

- **225** aplikime zyrtare;
  - **109** aplikime të depozituara nga qytetarët;
  - **1493** aplikime në e-albania.
- ▶ Janë realizuar përgjigjet e **851** aplikimeve, nga të cilat:
- **204** aplikime zyrtare;
  - **127** aplikime të depozituara nga qytetarët;
  - **520** aplikime në e-albania.

*Evidenca e indikatorëve për sektorin e arkivës, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Indikatorët	Periudha e raportimit 6M-I 2024		
	3M - I	3M - II	TOTALI
<b>Numri i aplikimeve të hyra në sistem</b>	<b>449</b>	<b>378</b>	<b>827</b>
Numri i aplikimeve zyrtare	117	108	225
Numri i aplikimeve qytetare	56	53	109
Numri i aplikimeve në e-Albania	276	217	493
<b>Trajtuar me përgjigje</b>	<b>471</b>	<b>380</b>	<b>851</b>
Numri i aplikimeve zyrtare	111	93	204
Numri i aplikimeve qytetare	64	63	127
Numri i aplikimeve në e-Albania	296	224	520

- ▶ Numri i aplikimeve të perealizuara është 18 (brenda afatit).
- ▶ **2** Aplikime Zyrtare (Aplikimi 470, dt.17.01.2020 ekzekutim për kthim  
(Aplikimi 2549, dt.29.04.2022 ekzekutim për kthim sendi)

- ▶ Aplikimi nr. 2029 dt.24.10.2023 në procedurë pritje.
- ▶ 2 Aplikime Qytetare për depozitim, në pritje të konfirmimit të gjykatës;
- ▶ Janë realizuar 51 kërkesa të adresuara Sek/Arkivës në sistemin on-line (AMS)SQDNE
- ▶ Janë skanuar vendimet gjyqesore të administruara me Memo nga arkiva në 16 dosje;
- ▶ Është realizuar vendosja në dispozicion e dokumentacionit si dhe informacioni që kërkohet nga sektorët e tjerë të ATP-së për realizimin e kthim përgjigjeve;
- ▶ Është realizuar vendosja në dispozicion e dokumentacionit të njehsuar të 238 dosjeve, sektorit të përfaqësimit ligjor;
- ▶ Janë vëne në dispozicion 2237 dosje inspektorëve të sektorit Kompensimit Fizik dhe Financiar dhe sektorëve të tjerë të ATP-së.

## 6.5. Shërbime elektronike të ofruara nga ATP

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, nga ATP ka vijuar punën me shërbimet elektronike të bëra publike:

- ▶ **Nga Portali e-Albania (AMS)**, janë trajtuar **852 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës e-Albania, nga të cilat:
  - **450 Ankesa** dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës;
  - **382 Kërkesa** për statusin dhe problematikat e dosjes.
- ▶ **Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)**

Nuk ka patur aplikime zyrtare në SQDNE nga institucionet.

- ▶ Stafi i ATP-së, si përdorues të Portalit Qeveritar “ONE STOP SHOP” merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe akseson nga sistemi dokumente si çertifikata për qytetarët.

*Evidenca e indikatorëve për shërbimet online, për periudhën Janar-Qershor 2024*

Indikatorët	3M - I	3M - II	TOTALI
Bashkëqeverisja	58	33	<b>91</b>
Portali E-Albania (AMS)	410	442	<b>852</b>
SQDNE	0	0	<b>0</b>

Përgjatë vitit 2024, Agjencia e Trajtit të Pronave vijon procesin e identifikimit dhe përcaktimit të shërbimeve të tjera që do t’i ofrohen qytetarëve në mënyrë elektronike nga portali i Bashkëqeverisjes dhe e-albania. Nga stafi i ATP-së vazhdon të punohet bazuar në Manualin e Përdorimit të vendosur në dispozicion nga AKSHI “Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik”.

## 7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit

### 7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2024 duke u bazuar në 6M – I 2024, i pa kuadruar nga thesari

Nr.	Emërtime	Llog. Ekonomike.	Buxheti 2024	Plani 6 - Mujor I, Viti 2024	Fakti 6 - Mujor I, Viti 2024	Realizimi në %
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	219,622,000	107,614,780	<b>83,760,586</b>	78%
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	601	36,676,000	17,971,240	<b>13,890,691</b>	77%
3	Mallra dhe shërbime të tjera	602	56,400,000	27,636,000	<b>15,284,483</b>	55%
4	Transferime korrente të brendshme	604	4,095,140,000	2,328,379,600	<b>1,000,000,000</b>	43%
5	Transferta për Buxhetet familjare (Fond i Veçantë)	606	200,000	200,000	-	0%
6	Shpenz. për rritjen e aktiveve të Trupëzuara	231	3,000,000	3,000,000	-	0%
7	Të Ardhura nga VKM të tjera					
	<b>Totali Buxhetor 1</b>		<b>4,411,038,000</b>	<b>2,484,801,620</b>	<b>1,112,935,760.00</b>	45%
1	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		905,000,000	280,315,750.06	<b>280,315,750.06</b>	100%
	<b>Totali Jashte Buxhetore 2</b>		<b>905,000,000</b>	<b>280,315,750</b>	<b>280,315,750.06</b>	
	<b>TOTAL Buxhetore dhe Jashte Buxhetore (Total 1+Total 2)</b>		<b>5,316,038,000</b>	<b>2,765,117,370</b>	<b>1,393,251,510.06</b>	50%

### 7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, per 6M – I 2024, i pa kuadruar nga thesari

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	1,724,095.00	Periudha 6 Mujore
2	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099		
3	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritit të tokës	7109901		
4	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtëshme e të truallit funksional të tyre	7109902		
5	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive	7109903		
6	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	234,032	
7	Të tjera	7115499		
8	Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 70%	7116101	192,700,326.34	Periudha 6 Mujore
9	Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 50%	7116102	118,091,403.00	Periudha 6 Mujore
	<b>TOTAL</b>		<b>312,749,856.34</b>	

<b>Totali 3+4+5+6+7</b>	<b>234,032</b>	Të ardhura që i shtohen ATP në fondin e kompensimit, në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë rritja e Autorizuar.
<b>Totali 8+9</b>	<b>310,791,729.34</b>	Të ardhura që i shtohen ATP për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Aluizni), për vitin 2024

### 7.3. Informacioni shpenzime për Aluiznin dhe Kompensim Financiar, dhe me raste të veçanta

<b>Totali</b>	<b>344,066,013.87</b>	<b>Nr. i subjekteve</b>
Xhirime Aluzini	<b>109,015,941.23</b>	100
Raste të veçanta	<b>233,637,934.38</b>	77
Kompensim financiar 20 me 80	<b>0.00</b>	0
Kompensim financiar në masë 100%	<b>1,412,138.26</b>	2